

KOMUNIKATË PËR MEDIA


Statistikat e Arsimit në Kosovë 2023/2024

07.06.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), publikon Statistikat e Arsimit për vitin akademik 2023/2024.

Më pak nxënës dhe studentë në vitin akademik 2023/2024 sesa një vit më parë

Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe studentëve në sektorin publik dhe privat



Rritje e lehtë e numrit të fëmijëve në çerdhe dhe parashkollor

Numri i fëmijëve në çerdhe dhe parashkollor për vitin shkollor 2023/2024 ishte 32 818, ku krahasuar me vitin paraprak (2022/2023), që ishte 30 996 fëmijë, kishte një rritje të lehtë të numrit prej 1 822 fëmijë më shumë.

Në sektorin publik në vitin shkollor 2023/2024 ishin 24 104 fëmijë ose 73,4%, ndërsa në sektorin privat 8 714 fëmijë ose 26,6%. Krahasuar me vitin paraprak (2022/2023) në sektorin publik ishin 24 366 fëmijë ose 78,6% ndërsa në sektorin privat 6 630 fëmijë ose 21,4%.

Interesim më i madh në sektorin privat në vitin akademik 2023/2024 krahasuar me 2022/2023

Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në vitin shkollor 2023/2024 ishte 215 431, prej tyre në sektorin publik ishin 206 941 ose 96,1% dhe në sektorin privat 8 490 ose 3,9%. Krahasuar me vitin shkollor (2022/2023) ku numri i nxënësve ishte 220 578, prej tyre në sektorin publik ishin 212 967 ose 96,5%, ndërsa në sektorin privat 7 611 ose 3,5%. Nga kjo mund të shohim se sektori publik ka një rënie të numrit të përgjithshëm, kurse sektori privat ka një rritje të lehtë të numrit të nxënësve krahasuar me vitin 2022/2023.

Më pak nxënës të regjistruar në sektorin publik

Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë në vitin 2023/2024 ishte 65 757, prej tyre në sektorin publik 60 837, ose 92,5%, ndërsa në sektorin privat ishin 4 920 nxënës ose 7,5%. Krahasuar me vitin paraprak 2022/2023 (që ishin 67 373 nxënës, në sektorin publik 63 029 ose 93,6% dhe në sektorin privat 4 344 ose 6,4%), ka rënie të numrit të përgjithshëm të nxënësve. Rënie më e madhe vërehet te sektori publik krahasuar me sektorin privat.

Rënie e lehtë e numrit të studentëve krahasuar me një vit më parë

Numri i përgjithshëm i studentëve në arsimin e lartë në vitin 2022/2023 ishte 70 357, prej tyre në universitetet publike 39 033 studentë, ose 55,5%, ndërsa në kolegjet private ishte 31 324 studentë, ose 44,5%. Krahasuar me vitin paraprak 2022/2023 (që ishin 71 948 studentë, prej tyre në universitetet publike 40 996 studentë, ose shprehur në përqindje 57,0%, ndërsa në kolegjet private ishte 30 952 studentë, ose 43,0%), ka rënie të lehtë të numrit të përgjithshëm të studentëve.

Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe studentëve në sektorin publik dhe privat, 2022/2023

Niveli	Arsimi	Publik 2022/23			Privat 2022/23			Gjithsej 2022/23		
		Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
0	Arsimi parashkollor (mosha 0-6)	12 535	11 831	24 366	3 478	3 152	6 630	16 013	14 983	30 996
1+2	Fillor dhe i mesëm i ulët (klasa 1 – 9)	109 462	103 505	212 967	4 125	3 486	7 611	113 587	106 991	220 578
3	I mesëm i lartë (klasa 10 – 13)	31 799	31 230	63 029	2 156	2 188	4 344	33 955	33 418	67 373
6 - 8	Universitar (6-8)	14 430	26 566	40 996	13 367	17 585	30 952	27 797	44 151	71 948
	Gjithsej	168 226	173 132	341 358	23 126	26 411	49 537	191 352	199 543	390 895

Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe studentëve në sektorin publik dhe privat, 2023/2024

Niveli	Arsimi	Publik 2023/2024			Privat 2023/2024			Gjithsej 2023/2024		
		Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
0	Arsimi parashkollor (mosha 0-6)	12 459	11 645	24 104	4 562	4 152	8 714	17 021	15 797	32 818
1+2	Fillor dhe i mesëm i ulët (klasa 1 – 9)	106 353	100 588	206 941	4 637	3 853	8 490	110 990	104 441	215 431
3	I mesëm i lartë (klasa 10 – 13)	30 430	30 407	60 837	2 441	2 479	4 920	32 871	32 886	65 757
6 - 8	Universitar (6-8)	13 078	25 955	39 033	13 833	17 491	31 324	26 911	43 446	70 357
	Gjithsej	162 320	168 595	330 915	25 473	27 975	53 448	187 793	196 570	384 363

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Statistikave të Arsimit për vitin akademik 2023/2024, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/Education>